



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE KORCË

NOTER BLEDAR E. ZAKE
ADRESA Lagje Nr.6, Rr. 28 Nentori,
Godina Nr.3
TEL: 0694086756

DEKLARATË NOTERIALE

(DEKLARATË ME PËRMBAJTJE TË TJERA)

Nr. repertori: 484

Nr. koleksioni: 337

Korce më 28/01/2022

Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë"



A2022033560039775755



Buku



DEKLARATË NOTERIALE

Sot, më datë 28/01/2022 , para meje Noter BLEDAR E. ZAKE, anëtar në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore KORÇË, me zyrë në adresën Korçe, Lagje Nr.6, Rr. 28 Nentori, Godina Nr.3, u paraqit personalisht:

DEKLARUES/IT:

Kopi Gusho, atësia Thomo, amësia Zygrafina, shtetas Shqiptar, lindur në Pogradec dhe banues në POGRADEC, me adresë Mitrush Kuteli 02620092; Nd. 14; H. 1; Pogradec; Pogradec; 7301; Pogradec, lindur më 13/04/1953, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 033354181 dhe nr. personal F30413058A, i cili deklaron se paraqitet ne cilesine e Adminsitratorit te Klubit te Futbollit Pogradeci.

DEKLARUES/IT:

Ilir Qirjako, atësia Sotir, amësia Dhimitrulla, shtetas Shqiptar, lindur në Ersekë, Kolonjë dhe banues në KOLONJË, me adresë Fan Noli 02540040; Nd. 13; H. 10; Ap. 7; Ersekë; Ersekë; 7401; Kolonjë, lindur më 23/01/1963, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 031175166 dhe nr. personal G30123017G, i cili deklaron se paraqitet ne cilesine e perfaqesuesit te Klubit te Futbollit Gramozi.

DEKLARUES/IT:

Eduard Duro, atësia Gazi, amësia Merjeme, shtetas Shqiptar, lindur në Çetë, Devoll dhe banues në DEVOLL, me adresë Elmas Mazelliu 02720030; Nd. 2; H. 2; Ap. 2; Bilisht; Bilisht; 7006; Devoll, lindur më 14/02/1976, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 035209941 dhe nr. personal H60214172W, i cili deklaron se paraqitet ne cilesine e Presidentit dhe Administratorit te Klubit te Futbollit Devolli .

DEKLARUES/IT:

Egli Malësija, atësia Arben, amësia Andriana, shtetas Shqiptar, lindur në Korçë dhe banues në KORÇË, me adresë 28 Nentori 02330009; Nd. 14; H. 3; Ap. 3; Korçë; Korçë; 7001; Korçë, lindur më 21/06/1987, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 035884350 dhe nr. personal I70621092K, i cili deklaron se paraqitet ne cilesine e administratorit te Klubit te Futbollit Maliq .

DEKLARUES/IT:

Spartak Meraku, atësia Shyqyri, amësia Vaibe, shtetas Shqiptar, lindur në Bilisht, Devoll dhe banues në DEVOLL, me adresë Superstrada E Devollit; Nd. 153; H. 7; Ap. 39; Bilisht; Bilisht; 7006; Devoll, lindur më 11/10/1970, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 037362369 dhe nr. personal H01011049D, i cili deklaron se paraqitet ne cilesine e administrototit te klubit te futbollit Bilisht Sport .

DEKLARUES/IT:

Vasjan Ballço, atësia Gjergji, amësia Drita, shtetas Shqiptar, lindur në Korçë dhe banues në KORÇË, me adresë Teli Ndini 02330291; Nd. 8; H. 1; Korçë; Korçë; 7002; Korçë, lindur më 06/01/1982, gjendja civile "beqar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u

Fq. I




garantova me Leternjoftim ID nr. 034949432 dhe nr. personal I20106041K, i cili deklaroi se paraqitet në cilësinë e administratorit të Futbollit Klub Korça 2011 .

Të cilët nën përgjegjësinë e tyre personale dhe në vullnet të lirë e të plotë, në bazë të nenit 79 të Kodit Civil Shqiptar, nenit 62, 63 , të ligjit nr. 110/2018 "Për Noterinë", më deklaruan si më poshtë vijon:

Ne përfaqësuesit ligjorë të subjekteve të cituara më lart,

- (1) Duke i bërë thirrje organeve të FSHF-së, për transparencë në lidhje me vendimmarrjen dhe veprimet e saj procedurale që kanë të bëjnë me organizimin e procesit zgjedhor për zgjedhjen e delegatëve të Asamblesë së Përgjithshme të FSHF;
- (2) Duke i konsideruar, vendimet e marra dhe veprimet procedurale të kryera, deri më tani, nga FSHF dhe disa SHRF, në lidhje me organizimin e zgjedhjeve për caktimin e delegatëve në punimet e Asamblesë së Përgjithshme të FSHF-së, që do të mbahet më datë 02.03.2022, si vendime dhe veprime procedurale: (i) "absolutisht të pavlefshme", (ii) të marra dhe të kryera në kundërshtim dhe mosrespektim të përcaktimeve të bëra në Statutin e SHRF-së dhe Rregulloren e Asamblesë së Përgjithshme të FSHF-së (e aplikueshme në rastin konkret), (iii) të marra dhe të kryera në kundërshtim, mosrespektim dhe tejkalim të vullnetit të shprehur dhe tagrave të deleguara të përfaqësuesve ligjorë të shoqatave/shoqërive anëtare të SHRFT, dhe (iv) të marra dhe të kryera (në disa raste) nga persona të cilëve përfaqësuesit ligjorë të shoqatave/shoqërive anëtare të SHRFT nuk u kishin deleguar asnjë tagër përfaqësuesi;
- (3) Të shqetësuar për mënyrën se si FSHF dhe disa SHRF kanë organizuar dhe kanë zhvilluar së fundmi, një proces zgjedhor të votimit të delegatëve me të drejtë vote që do të përfaqësojnë SHRF-të në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme të Zakonshme Zgjedhore të FSHF, në mungesë të plotë të transparencës dhe në mosrespektim të hapur të përcaktimeve statutore;
- (4) Të vetëdijshëm për pasojat e rënda që veprime dhe mosveprime të tilla të FSHF dhe disa SHRF-ve kanë shkaktuar në cënimin e besimit të komunitetit sportiv (kombëtar dhe ndërkombëtar) si dhe qytetarëve të Republikës së Shqipërisë në ekzistencën dhe zhvillimin nga FSHF dhe disa SHRF të një procesi të rregullt zgjedhor, të pavarur, të pamanipuluar, objektiv dhe transparent;
- (5) Duke e parë me shqetësim faktin që Komisioni i Verifikimit në FSHF, përmes Vendimit nr. 1, datë 10.01.2022, ka reduktuar apo shtuar, përpara procesit zgjedhor, numrin e delegatëve të SHRF-ve, në mënyrë arbitrare, jo transparente, të pa konsultuar paraprakisht dhe të pa argumentuar;
- (6) Duke mos pranuar idenë e shqyrtimit, diskutimit dhe votimit, në mbledhjet e SHRF-ve, të ndryshimeve statutore, të cilat tentojnë të ndryshojnë me emergjencë në këtë moment, aspekte të rëndësishme të procesit zgjedhor tashmë të iniciuar;
- (7) Duke dashur që ti japim një mesazh ndërgjegjësimit gjithë anëtarëve të Asamblesë së Përgjithshme të FSHF-së dhe duke kërkuar reagimin e tyre në drejtim të mbrojtjes dhe respektimit pa kompromis të përcaktimeve statutore dhe të drejtave tona të ligjshme për një proces të rregullt zgjedhor;
- (8) Duke vlerësuar qëndrimin e deritanishëm të shumicës së anëtarëve të Shoqatës Rajonale të Futbollit Tiranë, kanë mbajtur në mbrojtje të integritetit të një procesi të rregullt zgjedhor, duke na përfaqësuar në shqetësimet tona të ligjshme për zhvillimin deri më tani nga FSHF të një procesi zgjedhor, jo transparent dhe jo statutor;
- (9) Duke parë me shqetësim, tentativat e sajura mediatike dhe shkresore të FSHF-së, për të transformuar dhe inskenuar si një ndërhyrje politike në proces, çdo pretendim të përligjur të anëtarësisë për zhvillimin nga FSHF të një procesi të parregullt zgjedhor;



(10) Të vendosur për të restauruar besimin e komunitetit sportiv dhe qytetarëve shqiptar në integritetin që Federata Shqiptare e Futbollit dhe sporti i futbollit në Shqipëri meriton që të kenë;

Në zbatim të përcaktimeve të bëra në:

- (1) nenin 2, germa "e", nenin 3, germa "b", nenin 10, nenin 16, germa "f", nenin 17, germa "b", nenin 17, germa "q", nenin 32, pika 2, nenin 38, dhe nenet e tjera të statuteve respektive të SHRF-ve;
- (2) nenin 1, pika 2, nenin 4, pika 1, nenin 6, pika 1, nenin 31, nenin 32, dhe nenet e tjera respektive të Rregullores së Asamblesë së Përgjithshme të FSHF-së (të aplikueshme në rastin konkret);
- (3) nenin 4, nenin 5, nenin 8, nenin 9, nenin 19, nenin 20, nenin 25, nenin 28, të Ligjit nr. 8788, datë 07.05.2001 "Për organizatat jofitimprurëse", i ndryshuar;
- (4) nenin 8, neni 10, neni 11, neni 14, neni 17, të Ligjit nr. 80/2021 "Për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse";
- (5) nenin 44, nenin 46, neni 47, nenin 51, nenin 64 e vijues, të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë;
- (6) nenet respektive të Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare";

DEKLAROJMË:

Vendimmarrjen tonë respektive, për revokimin e menjëhershëm të çdo akti të nënshkruar deri më sot nga ana jonë si përfaqësues ligjor të subjekteve anëtare Shoqatës Rajonale të Futbollit Korçë, për caktimin e delegatëve në punimet e Asambleve të Përgjithshme të SHRFK të datës 28.01.2022; duke konsideruar çdo vendim apo veprim të mëtejshëm procedural të marrë nga këta delegatë, si një vendim apo veprim absolutisht i pavlefshëm, në mungesë të tagrave përkatëse përfaqësuese dhe të dënueshëm penalisht.

Ne përfaqësuesit ligjor të subjekteve anëtare të Shoqatës Rajonale të Futbollit Korçë jemi të vetmit përfaqësues ligjor me tagra të plota përfaqësimi në mbledhjet që do të zhvillohen nga Asamblenë e Përgjithshme të SHRFK dhe në mbledhjet që do të zhvillohen nga Asambleja e Përgjithshme e FSHF.

Deklarata e mësipërme, u hartua në gjuhën shqipe dhe u lexua nga unë Noteri me zë të lartë dhe në mënyrë të qartë në prani të deklaruesit/ses të mësipërm. Pasi ai/ajo deklaroi se u njoh dhe i kuptoi efektet juridike të aktit, e nënshkruan atë rregullisht përpara meje Noterit. Kjo deklaratë, u hartua nga unë Noteri në 2 (dy) kopje, me vlera të njëjta juridike; mbështetur në shprehjen e lirë e të plotë të vullnetit të deklaruesit. Njëra kopje vendoset në arshivën noteriale dhe tjetra i vihen në dispozicion deklaruesit/ses. Bashkëlidhur deklaratës gjendet dokumentacioni i mëposhtëm: Kopje e mijetit të identifikimit të personit të paraqitur; Kopje e Dokumentave të identifikimit.

Unë Noteri, verifikova identitetin e tij/saj nëpërmjet dokumenteve të identitetit cituar më sipër dhe pasi e gjeta përmbajtjen e aktit noterial të mësipërm, në përputhje të plotë me nenin nenit 62, pika 1, germa "II", të ligjit nr. 110/2018 "Për Noterinë", vërtetoj nënshkrimin e deklaruesit/ses. Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë Noteri deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjektit të kësaj deklarate, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

DEKLARUES/IT



Kopi Gusho *Kopi Gusho Jp*
 DEKLARUES/IT
 Ilir Qirjako *Ilir Qirjako*
 DEKLARUES/IT
 Eduard Duro *Eduard Duro*
 DEKLARUES/IT
 Egli Malësija *Egli Malësija*
 DEKLARUES/IT
 Spartak Meraku *S. Meraku*
 DEKLARUES/IT
 Vasjan Ballço *Vasjan Ballço*

NOTER

BLEDAR E. ZAKE



Bledar